

OPINIONI PUBLIK NË MALIN E ZI LIDHUR ME KORONAVIRUSIN

31 Mars 2020

Anketa e opinionit publik në Mal të Zi u krye nga
IPSOS me mbështetjen e [UNICEF Montenegro](#)



**Lani duart për të
paktën 20 sekonda me
ujë dhe sapun**


METODOLOGJIA

Zbatimi:	Të dhënat e mbledhura në periudhën 28-31 Mars 2020
Korniza e mostrës:	Popullsia e Malit të Zi 18+
Madhësia e mostrës:	812 të intervistuar
Lloji I mostrës:	Mostër shtresore përfaqësuese me një fazë Të anketuarit nga ekonomitë familjare
Lloji i anketës:	Anketa telefonike me pyetësor që zgjat afërsisht 15 minuta
Lokacionet e anketës:	19 komuna në Mal të Zi, mjedise urbane, periferike dhe rurale
Pas-shtresimi:	Sipas gjinisë, moshës
Gabimi:	±1.57% për ndodhi me incidencë prej 5% ±3.10% për ndodhi me incidencë prej 25% ±3.59% për ndodhi me incidencë prej 50% (gabim marginal)


MOSTRA

MARS 2020

N = 812 Σ = 100%




REZULTATET



Shqetësimet se ata dhe të dashurit e tyre mund të infektohen me koronavirus

Pak më shumë se 4/5 e qytetarëve malazezë janë të shqetësuar se ata ose të dashurit e tyre mund të infektohen me koronavirus

Të dhënat e shprehura në %



10 Sa shqetësoheni personalisht që ju dhe të dashurit tuaj mund të infektoheni me koronavirus?


• Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

Ndërgjegjësimi lidhur me numrin e veçantë të telefonit për të raportuar simptomat ose ekspozimin ndaj koronavirusit


Nëntë nga dhjetë qytetarë malazezë kanë dëgjuar se ekziston numëri i veçantë ku ata mund të raportojnë simptomat e koronavirusit, ndërsa më pak se gjysma e dinin saktësisht se cili ishte numri.

Të dhënat e shprehura në %

Popullsia totale e targetuar



Ata që janë në dijeni të numrit të veçantë të telefonit



A keni dëgjuar për numrin e veçantë të telefonit për raportimi e simptomave ose ekspozim ndaj koronavirusit?
Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

Cili është ai numër telefoni?
Baza: Ata që dëgjuan se kishte numër të veçantë telefoni për të raportuar simptomat ose ekspozimin ndaj koronavirusit, N = 731

Besimi në gatishmërinë e institucioneve për luftim me sukses

Ka më shumë të anketuar që besojnë në gatishmërinë e institucioneve për t'u marrë me sukses me koronavirusin sesa ata që janë skeptikë për këtë çështje..

Të dhënat e shprehura në %

■ 2 ■ 1 - Nuk kam aspak besim **NUK KAM BESIM (1+2)** ■ 4 ■ 5 - Kam shumë besim **KAM BESIM (4+5)**



⑩ Bazuar në ato që keni parë, lexuar ose dëgjuar, sa jeni të sigurt se institucionet e mëposhtme janë mjaft të përgatitura për të luftuar me sukses koronavirusin?

⑩ Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

Besimi në saktësinë e informacionit të koronavirusit të marrë nga...

Lidhur me informacionin për koronavirusin, të anketuarit u besojnë më shumë institucioneve, ndërsa ata janë kryesisht skeptikë në lidhje me informacionin e marrë nga media. Instituti i Shëndetit Publik është më i besuari.

Të dhënat e shprehura në %

■ 2 ■ 1 - Nuk kam aspak besim **NUK KAM BESIM (1+2)** ■ 4 ■ 5 - Kam shumë besim **KAM BESIM (4+5)**




⑩ Sa besim keni në saktësinë e informacionit për koronavirusin që merrni nga sa vijon?

⑩ Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

Pajtueshmëria me deklaratën - KORONAVIRUSI DO TË NDIKOJ NË GJENDJEN TIME FINANCIARE DHE ATË TË FAMILJES SIME

Pak më shumë se tre të katërtat e qytetarëve malazezë besojnë se koronavirusi do të ndikojë në gjendjen e tyre financiare.

Të dhënat e shprehura në %




- 10 Sa jeni dakord apo jo me pohimet e mëposhtme? Ju lutemi vlerësoni marrëveshjen në një shkallë nga 1 në 5,
- 10 ku 1 do të thotë që ju nuk pajtoheni fare dhe 5 do të thotë që jeni plotësisht dakord
- 10 Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

Pajtueshmëria me deklaratën – BLERJA E PRODUKTEVE VENDORE GJATË KËSAJ KRIZE DO TË FORCOJË EKONOMINË KOMBËTARE DHE DO TË SIGUROJË VENDET E PUNË

Pothuajse dy të tretat e të anketuarve besojnë se duke blerë produkte vendore ne forcojmë ekonominë kombëtare.

Të dhënat e shprehura në %



10 Sa pajtoheni apo nuk pajtoheni me pohimet e mëposhtme? Ju lutemi vlerësoni marrëveshjen në shkallë nga 1 në 5,


10 ku 1 do të thotë që nuk pajtoheni fare dhe 5 do të thotë që pajtoheni plotësisht

10 Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

Pajtueshmëria me deklaratën– BESOJ SE VAKSINA APO ILAÇI KUNDËR KORONAVIRUSIT DO TË ZHVILLOHET SË SHPEJTI NGA ANA E KOMPANIVE FARMACEUTIKE

Pothuajse gjysma e qytetarëve malazezë besojnë se ilaç kundër koronavirusit do të zhvillohet së shpejti

Të dhënat e shprehura në %



10 Sa pajtoheni apo nuk pajtoheni me pohimet e mëposhtme? Ju lutemi vlerësoni marrëveshjen në shkallë nga 1 në 5,


10 ku 1 do të thotë që nuk pajtoheni fare dhe 5 do të thotë që pajtoheni plotësisht

10 Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

Pajtueshmëria me deklaratën– QËNDRIMINË SHITËPI OSE IZOLIMI SHOQËROR ËSHTË MËNYRA E VETME PËR TË NGADALËSUAR PËRHAPJEN E KORONAVIRUSIT DHE KËSISOJ PARANDALUAR NGARKESËN E TEPËRT TË SISTEMIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE TË BËHET E MUNDUR QË TË GJITHË TË INFEKTUARIT TË MARRIN KUJDES ADEKUAT MJEKËSOR

Pothuajse të gjithë qytetarët, konkretisht 9 nga 10 sosh, besojnë se izolimi social është mënyra e vetme për të ngadalësuar përhapjen e koronavirusit.

Të dhënat e shprehura në %



10 Sa pajtoheni apo nuk pajtoheni me pohimet e mëposhtme? Ju lutemi vlerësoni marrëveshjen në shkallë nga 1 në 5,


10 ku 1 do të thotë që nuk pajtoheni fare dhe 5 do të thotë që pajtoheni plotësisht

10 Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

Pajtueshmeria me deklaratën – NESE MASAT E VETE-IZOLIMIT ZGJASIN SHUME, UNË BESOJ SE DO TË JETË E VËSHTIRË PËR NJERËZIT QË TË PËRBALLEN ME STRESIN

nga ana tjetër, shtatë nga dhjetë qytetarë besojnë do të jetë e vështirë për njerëzit të përballen me stresin nëse vetë-izolimi zgjat shumë.

Të dhëmat e shprehura në %



10 Sa pajtoheni apo nuk pajtoheni me pohimet e mëposhtme? Ju lutemi vlerësoni marrëveshjen në shkallë nga 1 në 5,

10 ku 1 do të thotë që nuk pajtoheni fare dhe 5 do të thotë që pajtoheni plotësisht

10 Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

PASOJAT EKONOMIKE AFATGJATE TË KORONAVIRUSIT

Rreth tre të katërtat e qytetarëve besojnë se Mali i Zi do të vuajë pasoja të rënda ekonomike, ndërsa shtatë nga dhjetë qytetarë besojnë se shumë do të humbasin punën e tyre për shkak të kësaj krize. Nga ana tjetër, rreth gjysma e tyre besojnë se kompanitë do të mbyllen përkohësisht ose përgjithmonë.

Të dhënat e shprehura në %

■ 2 ■ 1- Nuk është e mundshme fare **NUK ËSHTË E MUNDSHME (1+2)** ■ 4 ■ 5 - Është shumë e mundshme **E MUNDSHME (4+5)**

Ekonomia e Malit të Zi do të vuaj disa pasoja serioze



Shumë njerëz do të humbin punën e tyre



Çmimet e shumë produkteve do të rriten



Kompanitë në Mal të Zi do të mbyllen përgjithmonë ose përkohësisht




10 Çfarë mendoni, sa është e mundur që efektet e mëposhtme të koronavirusit të përjetojnë në afat të gjatë?

10 Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

MBËSHTETJA PËR QEVERINË E MALIT TË ZI NË KRIJIMIN E ORGANIT KOMBËTAR TË KOORDINIMIT DHE MIRATIMIN E MASAVE PËR TË LUFTUAR KORONAVIRUSIN

Mbështetja për Qeverinë e Malit të Zi në krijimin e Organit Kombëtar të Koordinimit për të luftuar koronavirusin dhe miratimin e një sërë masash është në nivel shumë të lartë - 95% e të anketuarve e mbështesin atë.

Të dhënat e shprehura në %



⑩ The Government of Montenegro has set up a National Coordinating Body to Combat Infectious Diseases whose work has been intensified recently, in order to fight the coronavirus. This body has adopted a whole set of measures to protect public health from coronavirus.

⑩ To what extent do you support these measures by the Government or the National Coordination Body??

⑩ Base: Total target population, N=812

SHKALLA E MBËSHTETJES PËR MASAT EMERGJENTE

Në përgjithësi, shumica e masave mbështeten shumë nga publiku në Mal të Zi, veçanërisht ndalimi i të gjitha tubimeve private dhe publike, vetë-izolimi, karantina dhe mbyllja e mjediseve të hotelierisë. Një në çdo katër të anketuar nuk mbështet botimin e emrave të personave në vet-izolim.

Të dhënat e shprehura në %

■ 2 - Nuk e mbështes deri diku


■ 3 - E mbështes deri diku

■ 1 - Nuk e mbështes fare

■ 4 - E mbështes plotësisht

NUK E MBËSHTES (1+2)

E MBËSHTES (3+4)




¹⁰ Lidhur me masat emergjente të miratuara nga Qeveria e Malit të Zi deri më tani, në çfarë mase i mbështesni secilën prej tyre veç e veç?

¹⁰ Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

RESPEKTIMI PERSONAL I MASAVE PARANDALUESE TË VENDOSURA NGA QEVERIA E MALIT TË ZI

Nëntë nga dhjetë qytetarë thonë se u përmbahen masave të vendosura nga Qeveria e Malit të Zi deri më tani.


Të dhënat e shprehura në %



RESPEKTIMI I MASAVE PARANDALUESE TË VENDOSURA NGA QEVERIA E MALIT TË ZI NGA INDIVIDË NË AFËRSI

Lidhur me individët në afërsi, tre të katërtat e të anketuarve besojnë se u përmbahen masave të vendosura.

Të dhënat e shprehura në %




10 A i përmbahen njerëzit e tjerë në afërsinë tuaj masave të qeverisë që rekomandojnë qëndrimin në shtëpi, shmangien e mbledhjeve publike dhe shmangien e kontakteve me njerëz të tjerë?

10 Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

ARSYET PSE INDIVIDËT NË RRETHIN TUAJ NUK I PËRMBAHEN MASAVE EMERGJENTE

Vlerësimi më i zakonshëm lidhur me atë se pse qytetarët mendojnë se individët në rrethin e tyre nuk u përmbahen masave emergjente ka të bëjë me nënvlerësimin e rrezikut të virusit, si dhe domosdoshmërinë për të shkuar në punë.

Data expressed in %



10 Sipas mendimit tuaj, a mund të më thoni pse ata pjesërisht i përmbahen ose nuk u përmbahen këtyre masave?

10 Baza: Ata që thonë se njerëzit në rrethin e tyre të ngushtë pjesërisht po respektojnë ose nuk u përmbahen masave emergjente, N=812

ÇFARË DO T'I BËNTE QYTETARËT T'I PËRMBAHEN MASAVE EMERGJENTE?

Një e katërta e qytetarëve malazezë besojnë se gjobat do të rrisin respektimin e masave. Sidoqoftë, më shumë se një e treta e tyre nuk mund të thonë se çfarë mund t'i inkurajojë qytetarët t'i përmbahen këtyre masave në masë më të madhe.

Të dhënat e shprehura në %




A PËRDOREN SHËRBIMET ONLINE MË SHUMË QË NGA FILLIMI I KRIZËS SË SË KORONAVIRUSIT?


Që nga fillimi i krizës së koronavirusit, një e pesta e qytetarëve kanë përdorur e-banking më shpesh, dhe çdo i dhjeti qytet ka bërë blerje me të shpeshta online dhe shkëmbime më të shpeshta bankare elektronike.

Data expressed in %

Blerje online



E-banking (shkëmbime me bankën pa shkuar në bankë/bankomat)




A keni filluar të përdorni shërbimet e mëposhtme më shpesh që nga fillimi i krizës së koronavirusit sesa para pandemisë:
Baza: Popullsia totale e targetuar, N = 812

A DO TË ISHIT TË GATSHËM TË PËRDORNI SHËRBIMET E MËPOSHTME ONLINE

Gati dy të tretat e qytetarëve thonë se do të ishin të gatshëm të përdorin një shërbim vullnetar online dhe të angazhohen për të ndihmuar të moshuarit dhe të sëmurët. Për më tepër, më shumë se gjysma e qytetarëve shprehën gatishmërinë për të përdorur shërbime të tjera në Internet. Nga ana tjetër, ata janë më pak të gatshëm të përdorin palestër online me instruktor ose trajner.

Të dhënat e shprehura
në %




10 Duke pasur parasysh situatën aktuale dhe sasinë e kohës që kaloni në shtëpi, a do të ishit gati të përdorni shërbimet e mëposhtme online?

10 Baza: Popullsia totale e synuar, N = 812

MASAT EKONOMIKE TË MIRATUARA NGA QEVERIA PËR MBËSHTETJEN E QYTETARËVE DHE EKONOMISË

3/4 e qytetarëve kanë dëgjuar për masat ekonomike të ndërmarra nga Qeveria e Malit të Zi për mbështetjen e qytetarëve dhe bizneseve gjatë pandemisë së koronavirusit.

Të dhënat e shprehura në %




A keni dëgjuar për masat ekonomike të miratuara nga Qeveria e Malit të Zi për të lehtësuar jetën e qytetarëve dhe për të mbështetur ekonominë në kohën e pandemisë së koronavirusit?

Baza: Popullsia totale e synuar, N = 812

RËNDËSIA PERSONALE E MASAVE EKONOMIKE TË MIRATUARA NGA QEVERIA PËR MBËSHTETJEN E QYTETARËVE DHE EKONOMISË

Ndër masat ekonomike të miratuara, vonesa në ripagimin e kredisë dhe ndihma e njëhershme për pensionistët janë masat më të rëndësishme për qytetarët malazezë. Nga ana tjetër, afër një e treta e qytetarëve nuk veçojnë asnjërën masë ekonomike si më të rëndësishmen.

Të dhënat e shprehura në %




Cila nga masat ekonomike të miratuara është personalisht domethënëse për JU?

Baza: Ata që kanë dëgjuar për masat ekonomike të Qeverisë së Malit të Zi të miratuara për të lehtësuar jetën e qytetarëve dhe për të mbështetur ekonominë gjatë pandemisë së koronavirusit

MASA EKONOMIKE TË CILËN QEVERIA DUHET TË MIRATOJË PËR TË MIRËN PUBLIKE

Ndihma financiare, subvencionet dhe mospagimi i faturave të shërbimeve, janë tri masat e reja ekonomike që zakonisht propozohen nga qytetarët.

Të dhënat e shprehura në %



A mund të më thoni nëse ka ndonjë masë ekonomike që Qeveria duhet të miratojë dhe që do të ishte personalisht domethënëse për JU?


Baza: Popullsia totale e synuar, N = 812

SHIKIMI I KANALIT TELEVIZIV 'MËSO NË SHTËPI' NË 7 DITËT E FUNDIT


Më shumë se dy të tretat e qytetarëve kanë parë të paktën një herë kanal televiziv 'Mëso në shtëpi' në javën e kaluar. Shumica e qytetarëve që kanë parë këtë kanal televiziv janë të kënaqur me cilësinë e përmbajtjes.

Të dhënat e shprehura në %

Popullsia totale e synuar



Ata që kanë shikuar kanal televiziv 'MËSO NË SHTËPI' në 7 ditët e fundit



Në 7 ditët e fundit, a keni shikuar të paktën një klasë të transmetuar në kanal televiziv të quajtur 'MËSO NË SHTËPI'?

Baza: Popullsia totale e synuar, N = 812

10 Sa jeni të kënaqur me cilësinë e përmbajtjes në këtë kanal? Ju lutemi vlerësojeni atë në shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 do të thotë se nuk jeni aspak të kënaqur dhe 5 që jeni plotësisht të kënaqur.

10 Baza: Ata që shikuan të paktën një herë në 7 ditët e fundit kanal televiziv për klasat vijuese të quajtur 'MËSO NË SHTËPI' = 554

**KY STUDIM PUBLIK NË MAL TË ZI U REALIZUA
NGA IPSOS ME MBËSHTETJEN E UNICEF-IT TË
MALIT TË ZI**

RRETH IPSOS

Ipsos renditet e treta në industrinë globale të hulumtimeve. Me prani të fortë në 87 vende, Ipsos punëson më shumë se 16,000 persona dhe ka aftësinë për të realizuar programe hulumtuese në më shumë se 100 vende. E themeluar në Francë në vitin 1975, Ipsos kontrollohet dhe menaxhohet nga profesionistë të hulumtimit. Ata kanë ndërtuar një grup të fortë rreth një pozicionimi multi-specialist - Kërkime mediatike dhe reklamuese; Hulumtimi i marketingut; Menaxhimi i marrëdhënieve midis klientit dhe punonjësit; Opinione & kërkim shoqëror; Grumbullimi dhe shpërndarja e të dhënave Mobile, Online, Offline.

Ipsos renditet në Eurolist - NYSE-Euronext. Kompania është pjesë e SBF 120 dhe indeksit Mid-60 dhe është e kualifikueshme për Shërbimin e Zgjidhjes së Shtyrë (Deferred Settlement Service) (SRD).

Kodi ISIN FR0000073298, Reuters ISOS.PA,
Bloomberg IPS:FP
www.ipsos.com

GAMECHANGERS

Në Ipsos jemi kureshtarë të pasionuar për njerëzit, tregjet, markat dhe shoqërinë. Ne ofrojmë informacione dhe analiza që e bëjnë botën tonë të ndërlikuar më të lehtë dhe më të shpejtë për të naviguar dhe frymëzojnë klientët tanë që të marrin vendime më të mençura.

Ne besojmë se puna jonë është e rëndësishme. Siguria, thjeshtësia, shpejtësia dhe përmbajtja vlejné në gjithçka që ne bëjmë. Përmes specializimit, ne u ofrojmë klientëve tanë thellësi unike të njohurisë dhe ekspertizës. Të mësuarit nga përvoja të ndryshme na jep perspektivë dhe na frymëzon që me guxim t'i vëmë në pikëpyetje gjërat, për të qenë kreativ.

Duke ushqyer një kulturë bashkëpunimi dhe kurioziteti, ne tërheqim kalibrin më të lartë të njerëzve që kanë aftësinë dhe dëshirën për të ndikuar dhe formësuar të ardhmen.

“GAME CHANGERS” - motoja jonë - përmbledh ambicien tonë.